



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.70, datë 28.06.2021

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 541'801'000 LEKË PA TVSH, TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 333, DATË 2.6.2021 "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) NË BASHKITË DURRËS, KRUIJË DHE RROGOZHINË"

Në zbatim të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Ligjit Nr.68/2017,"Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 333, datë 2.6.2021 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në bashkitë Durrës, Kruijë dhe Rrogozhinë", si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 541'801'000 lekë pa tvsh, të përfituar në zbatim Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 333, datë 2.6.2021 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të

banimit në ndërtesa (pallat) në bashkitë Durrës, Krujë dhe Rrogozhinë”, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ato individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime në Bashkinë Durrës i detajuar sipas tabelës së mëposhtme:

VKM që ka miratuar fondin	Gr.	Kap.	Progami	Llog. ekon	Kodi i produktit	Emërtimi i projektit	Fondi në lekë
NR.333 DT.2.6.2021	00	1	04960	606	94902AB	Financim i rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ato individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime	541,801,000
						TOTALI	541,801,000


- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtorja e Buxhetit dhe Drejtorja Ekonomike.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 28.06.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 451/prot.
2



Durrës, më 01.07.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.70 datë 28.06.2021: Për miratimin e përdorimit të fondit prej 541.801.000 lekë pa tvsh, të përfituar në zbatim të VKM Nr 333 datë 02.06.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkitë Durrës, Krujë dhe Rrogozhinë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

